

URDHËR
Nr. 621, datë 13.12.2024

**PËR DISA NDRYSHIME NË URDHRIN NR. 189, DATË 4.5.2022, TË MINISTRIT
TË DREJTËSISË, “PËR MIRATIMIN E FORMËS DHE PËRMBAJTJES SË
DEKLARATËS TIP TË NËNSHKRUAR PREJ PËRKTHYESIT ZYRTAR”**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetues; të nenit 7, pika 2, të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, të ndryshuar; të nenit 6, pika 4, të ligjit nr. 82/2021, “Për përkthimin zyrtar dhe profesionin e përkthyesit zyrtar”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

Në urdhrin nr. 189, datë 4.5.2022, të ministrit të Drejtësisë, “Për miratimin e formës dhe përmbajtjes së deklaratës tip të nënshkruar prej përkthyesit zyrtar”, bëhen këto ndryshime:

1. Pika 2 e urdhrit, ndryshon me përmbajtjen e mëposhtme:

“2. Deklarata e përkthyesit zyrtar plotësohet, nënshkruhet nga përkthyesi zyrtar dhe vulloset me vulën e tij.”.

2. Shtojca bashkëlidhur urdhrit nr. 189, datë 4.5.2022, zëvendësohet me shtojcën bashkëlidhur këtij urdhri dhe pjesë përbërëse e tij.

3. Ngarkohen përkthyesit zyrtarë, Drejtoria e Përkthimit Zyrtar për Bashkëpunimin Ndërgjyqësor dhe Certifikimin e Marrëveshjeve Ndërkombëtare dhe Drejtoria e Monitorimit të Profesioneve të Lira për ndjekjen dhe zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I DREJTËSISË
Ulsi Manja

SHTOJCË

“DEKLARATA E PËRKTHYESIT ZYRTAR

Unë, _____, përkthyes/e zyrtar/e i/e gjuhës _____, certifikuar nga Ministria e Drejtësisë me nr. certifikate _____, datë _____, deklaroj se kam përkthyer tekstin që më është paraqitur nga gjuha e burimit _____ në gjuhën e synuar _____ me saktësi, me kujdesin e duhur dhe me përgjegjësi ligjore.

Data _____._____._____

Vula dhe nënshkrimi i përkthyesit zyrtar”.